

VENDIM
Nr. 148, datë 26.3.1997

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.160, DATË
9.7.1975 “PËR NORMAT E USHQIMIT TË USHTRISË DHE TË ORGANEVE E
REPARTEVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME”**

Për të përmirësuar kushtet e jetesës së efektivave të njësive të emergjencës që do të angazhohen në ruajtjen dhe trajtimin e ndihmave, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në nenin 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.160, datë 9.7.1975, pasqyra nr.1, pika 8, të shtohet paragrafi:

“Me normën e ushqimit nr.8 të furnizohen:

- a) efektivi i brigadës së tankeve në Zall-Herr;
- b) efektivi i batalionit të sigurimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ai i ruajtjes e i mbrojtjes së aerodromit të Rinasit;
- c) efektivi i brigadës së transportit;
- ç) efektivi i Policisë Ushtarake që do të angazhohet në ruajtjen e ndihmave;
- d) kuadrot ushtarakë të brigadës “Komando”, si dhe të gjithë kuadrot e reparteve të tjera që do të marrin pjesë dhe do të angazhohen në këtë veprimtari”.

2. Efektet ekonomike nga ndryshimet e mësipërme të përballohen brenda fondeve buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino